



Datë: 17.11.2025
Numër Protokolli: 7393/2025

A.nr.1701/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1701/2025, të datës 16.09.2025, të parashtruar nga ankuesja A-S-B, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Zyra Ligjore “Kaçandolli-Bekteshi”-Valentina Kaçandolli-Bekteshi, kundër organit të punësimit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 17.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Shfuqizohet Përgjigja në kërkesë me numër protokolli 6364 e datës 27.08.2025, e U.D Udhëheqëses së Sektorit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa lënda e ankueses A-S-B, kthehet në *rishqyrtim* dhe *rivendosje* tek organi i njëjtë.

II. Obligohet U.D Udhëheqësja e Sektorit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ashtu që të rishqyrtoj dhe vendos për Kërkesën e palës ankuese me numër protokolli 6222 të datës 21.08.2025, dhe të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi duke marr për bazë pikëpamjet e dhëna juridike si në këtë vendim.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, A-S-B (*në tekstin e mëtejme referuar: ankuesja*), me datë 19.06.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6160/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.1710/2025, kundër Përgjigjes në kërkesë me numër protokolli 6364 të datës 27.08.2025, të organit të punësimit: Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me datë 23.09.2025 e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa me datë 25.09.2024 ka pranuar shkresat e kërkuara të lëndës.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 7081/2025 të datës 30.10.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) administroi këto prova: Ankesën me numër 6160/2025 të datës 16.09.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshill; Autorizimin e datës 12.08.2025; Dokument identifikimi i ankueses; Kërkesën e datës 21.08.2025; Vendimin me Nr.Ref.AUV.01-105/2014 të datës 07.03.2014; Akt emërimit me numër protokolli 1496 të datës 01.04.2014; Përgjigjen në kërkesë me numër protokolli 6364 të datës 27.08.2025; Akt emërimit me numër protokolli 1033 të datës 20.03.2012; Vendimin me Nr.Ref.AUV.1-162/2014 të datës 10.03.2014; E-mailin e datës 05.08.2025; E-mailin e datës 29.04.2024; E-mailin e datës 20.05.2024; Kërkesën me numër protokolli 1293 të datës 01.03.2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 23.09.2025; Përgjigjen në ankesë 25.09.2025; Vendimin me Nr.AUV.01-57/2012 të datës 31.01.2012; E-mailin e datës 07.11.2018; Propozimet e institucioneve në DMZP; E-mailin e datës 16.03.2023; Vendimin me Nr.04/128 të datës 16.02.2023; E-mailin e datës 29.04.2024; Listat e pagave të ankueses; Formularët e vlerësimit të datës: 24.01.2023, 31.01.2024 dhe 28.02.2025; Vendimin me Nr.Ref.AUV.01/566/2025 të datës 21.07.2025; E-mailin e datës 30.10.2025; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i lartë për të hyra vetanake të datës 01.06.2011; Akt emërimit me numër protokolli 1196 të datës 23.03.2012; Akt emërimit me numër protokolli 2997 të datës 08.07.2013; Vendimin me Nr.Ref.295/2013 të datës 08.07.2013; Akt emërimit me numër protokolli 2998 të datës 08.07.2013; Vendimin me Nr.Ref.296/2013 të datës 08.07.2013; Akt emërimit me numër protokolli 4728 të datës 07.07.2021; Akt emërimit me numër protokolli 2999 të datës 08.07.2013; Vendimin me Nr.Ref.297/2013 të datës 08.07.2013; Akt emërimit me numër protokolli 5219 të datës 21.08.2017; Vendimin me Nr.Ref.AUV.01-230/2018 të datës 05.09.2018; Listat e pagave të Koordinatorëve të Zyrrave Regjionale (Udhëheqësve); Formularët e vlerësimit të rezultateve të punës të datës: 10.02.2025; Akt emërimit me numër protokolli 3517 të datës 22.08.2013; Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ka bazë të mjaftueshme ligjore që lënda e ankueses duhet të kthehet në **ri-shqyrtim** dhe **rivendosje**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankuesja është e punësuar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, përkatësisht sipas Vendimit me Nr.01-57/2012 të datës 31.01.2012, nga pozita *Zyrtare e të hyrave-Zotuese*, është caktuar në pozitën *Zyrtare e Lartë për të Hyrat Vetanake dhe Zotues*, për të cilën pozitë në Sektorin/Njësinë e Buxhetit dhe Financave të Drejtorisë së Administratës, të njëjtës me datë 20.03.2012, i është lëshuar Akt emërimi me numër protokolli 1033. Më tej, sipas Vendimit me Nr.Ref.AUV.01-105/2014 të datës 07.03.2014, të Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, ankuesja është caktuar në pozitën *Koordinatorë për të hyra* në Drejtorinë për Administratë, me koeficient të përcaktuar të pagës **nëntë (8)**, mirëpo i cili Vendim është shfuqizuar sipas pikës V të dispozitivit të Vendimit me Nr.Ref.AUV.01-162/2014, të datës 10.03.2014, të Kryeshefit Ekzekutiv të AUV-it, ku si rrjedhojë ankuesja është caktuar në pozitën e njëjtë atë Koordinatorës për të hyra, por se në pikën II është përcaktuar koeficienti **tetë (8)**. Ndërsa, me datë 01.04.2014, rezulton se ankueses i është lëshuar Akt emërimi me numër protokolli 1496, për këtë pozitë pune me koeficient të pagës **tetë (8)**.

Tutje, me datë 21.08.2025, ankuesja ka parashtruar kërkesë me numër protokolli 6222, pranë organit përkatës të punësimit, përmes së cilës ka kërkuar kompensimin e diferencës së pagës nga koeficienti 8 në koeficientin e pagës 9, si dhe po ashtu pozitën e së njëjtës Koordinatorë për të hyra, ta klasifikoj në kategorinë drejtues i ulët me koeficient të pagës 7.35.

Ndërsa, U.D Udhëheqësja e Sektorit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, përmes Përgjigjes në kërkesë me numër protokolli 6364 të datës 27.08.2025, ka njoftuar ankuesen duke theksuar se citoj: “ *Për më shumë sipas kërkesës, nëpërmjet e-mail, me datë 05.08.2025, Sektori i Personelit të AUV ka njoftuar znj. Svarça-Berisha: DMZP/Thesari nuk ka aprovuar propozimin e Sektorit të Personelit të AUV për korrigjim të kategorisë së pozitës Koordinator për të Hyra nga profesional 1 në Drejtues i ulët, si dhe nuk ka aprovuar propozimin për korrigjim të koeficientit në 7.35 për pozitën Koordinator për të hyra.*”

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshilli, kundër Përgjigjes në kërkesë me numër protokolli 6364 të datës 27.08.2025, pretendon se zyrtarët tjerë të sistemuar në pozitën e njëjtë/Koordinator, janë paguar me koeficient të ndryshëm, gjegjësisht me koeficient 9, dhe se me këtë rast e njëjta është diskriminuar nga organi përkatës i punësimit, si dhe po ashtu e njëjta konteston përgjigjen përkatëse për nga struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, ashtu që kërkon nga Këshilli aprovimin e ankesës, me detyrimin që organi i punësimit të rishqyrtoj kërkesën e datës 21.08.2025, të parashtruar nga ankuesja.

Kolegji i Këshillit, lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative, konstaton se meqë pala ankuese, respektivisht ankuesja më datë 21.08.2025 ka parashtruar kërkesë tek organi i punësimit, atëherë lidhur me obligimin e organit publik që të shqyrtoj në mënyrë të drejtë kërkesën dhe të nxjerr aktin administrativ, iu referua Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative respektivisht nenit 11 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2, i cili përcakton se: “3. *Organi u siguron personave të interesuar dhe palëve informacion të saktë, të qartë dhe të kuptueshëm rreth: 3.2. kërkesave thelbësore ligjore si dhe procedurave e formaliteteve të parashikuara për nxjerrjen e një akti administrativ apo realizimin e një akti real të kërkuar, përfshirë këtu edhe dokumentet dhe deklaratat që duhen parashtruar*”, nenit 27 paragrafi 1, i cili përcakton se: “1. *Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, zyrtari përgjegjës zhvillon procedurën administrative, **vendos për çështjen**, e nënshkruan vendimin si dhe siguron njoftimin e palës*”, nenit 97 paragrafi 1, i cili përcakton se: “1. *Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative*”, dhe erdhi në përfundimin se në secilin rast kur institucioni punëdhënës në cilësi të shprehjes së autoritetit zyrtar kur zgjedh një çështje administrative apo shqyrton një kërkesë të palës lidhur me të drejtat apo detyrimet e tij, duhet të nxjerrë akt administrativ përmes të cilit vendos për çështjen e cila ka qenë objekt shqyrtimi, ndërsa në rrethanat e rastit konkret objekti shqyrtimi i procedurës së filluar administrative ka qenë kërkesa e ankuses për kompensimin e diferencës së pagës nga koeficienti 8 në koeficientin 9, si dhe klasifikimin e pozitës Koordinatorë për të hyra, në kategorinë drejtues i ulët me koeficient të pagës 7.35, ndërsa në konstatimin e Kolegjit të Këshillit, U.D Udhëheqësja e Sektorit të Personelit në AUV, përmes Përgjigjes në kërkesë me numër protokolli 6364 të datës 27.08.2025, nuk ka vendosur lidhur me çështjen e iniciuar, veprim ky që bie ndesh me nenin 27 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përderisa sipas nenit 2 paragrafi 1 i të njëjtit ligj në secilin rast kur organ publik në realizimin e autoritetit publik është i obliguar të zbatojë dispozitat e LPPA-së kur vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave, si dhe çdo rast tjetër kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e një akti administrativ, gjegjësisht e njëjta ka sqaruar se DMZP/Thesari nuk ka aprovuar korrigjimin e pozitës së ankuses në kategorinë drejtues i ulët, mirëpo nuk ka ofruar arsyetim apo nuk rezulton se ka trajtuar pretendimin lidhur me kompensimin e diferencës së pagës, nga koeficienti 8 në 9.

Tutje, Kolegji i Këshillit në vështrim të të gjeturave dhe konstatimeve të dhëna si më lartë, analizoi edhe dispozitat e nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë.; si dhe nenit 48 paragrafi 1, të këtij ligji, ku përcaktohet se: 1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.”*, dhe mbi këtë bazë konstatoi se Përgjigja në kërkesë me numër protokolli 6364 e datës 27.08.2025, është akt i paligjshëm sikurse përcaktohet edhe me dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1. 3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ”* pasi që përmes të njëjtit akt nuk tregohet çfarë është vendosur, nuk ka shpjegim të gjendjes faktike mbi të cilën është marrë vendimi dhe po ashtu akti nuk përmban bazën ligjore dhe arsyen pse është e zbatueshme në rrethanat e rastit konkret, prandaj Kolegji i Këshillit vendosi si në pikën e I të dispozitivit të këtij vendimi, ashtu që shfuqizohet Përgjigja në kërkesë me numër protokolli 6354 e datës 27.08.2025, e U.D Udhëheqëses së Sektorit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë për shkak të shkeljeve procedurale administrative të përcaktuara me dispozitat e LPPA-së.

Andaj, nga se u tha si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi Kolegji i Këshillit, meqenëse konstatoi se me rastin e trajtimit të kërkesës së ankueses të datës 21.08.2025, është vepruar në kundërshtim me dispozitat e aplikuara të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi që lëndën e ankueses ta kthej tek U.D Udhëheqësja e Sektorit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, në rishqyrtim dhe rivendosje, ndërsa kjo e fundit me rastin e shqyrtimit të kërkesës së ankueses të datës 21.08.2025 duhet të marrë për bazë pikëpamjet juridike të vendimit të Këshillit, në at mënyrë që lidhur me kërkesën e palës për kompensim material të vendos sipas dispozitave të ligjit për pagat dhe dispozitat e aplikuara të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, pasi që pala ankuese pretendon se institucioni punëdhënës me të cilin ka marrëdhënie kontraktuale të punës e ka diskriminuar në raport me realizimin e pagës me zyrtarët e këtij organi punësimi, rrjedhimisht ka shkelur të drejtat që burojnë nga marrëdhënia e punës, dhe se mbi këtë bazë U.D Udhëheqësja e Sektorit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, përmes aktit administrativ duhet të vendos për çështjen e hapur administrative sipas Kërkesës me numër protokolli 6222 të datës 21.08.2025, ndërsa palën duhet ta njoftojë me aktin e nxjerrë siç parashihet me dispozitat e LPPA-së.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në kuadrin ligjor të përmendur si më lartë lidhur me obligimin e organit përkatës për të vendosur lidhur me kërkesën e palës, e obligon U.D Udhëheqësen e Sektorit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, si organ që e ka nxjerr aktin e kontestuar me qëllim që të nxjerr akt administrativ të ri duke shqyrtuar dhe vendosur lidhur me Kërkesën me numër protokolli 6222 të datës 21.08.2025, në atë mënyrë që gjatë rishqyrtimit të kërkesës të shqyrtohen dhe të vendoset për të gjitha pretendimet e palës ankuese sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 47 paragrafi 1 dhe 48 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1701/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësueses së autorizuar të ankueses, Valentina Kaçandolli -Bekteshi;
- U.D Udhëheqëses së Sektorit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.